



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Uprava za Opštu Administraciju

Directory of General Administration



## Raporti i punës për periudhën Janar - Dhjetor 2024

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës së zyrtarit për Barazi Gjinore

- Raportimi për përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar – Dhjetor 2023.
- Përgaditja e dy raporteve si kryesues i komisionit për vlerësimin e pronës komunale në këmbim, ku raporti i është dërguar zyres së kryearit dhe drejtoris për Kadastër, gjeodezi.
- Takim me kryetarin dhe grupin e performancës komunale, qëllimi i takimit, rezultatet e arritura në performancë.
- Takim në zyre me zyrtarët nga OSBE, Daniel Lazo dhe Selajdin Cena dhe koordinatoresha e njesisë për të drejtat e njeriut, qëllimi i takimit ishte draftimi i memorandumit për themelimin e Mekanizmit komunal kundër dhunës në familje, që u dakordua të fillojmë me përgaditjet, të mbajmë edhe një takim me kryetarin dhe deri në muajin Prill të jetë i themeluar ky mekanizëm.
- Trajnim dy ditor me temën: “Të kuptuarit e traumës dhe efekteve të ndërlidhur me dhunën në baza gjinore”, dita e dytë: Qasja me viktimën në qendër, organizuar nga Medica Kosova-Gjakovë.
- Mbledhja e parë e KKS-së për vitin 2024.
- Marrja pjesë në trajnimin lidhur me përgatitjen për procesin e deklaramit të pasurisë. Trajnimi u mbajt nga “Instituti i Kosovës për Administratë Publike IKAP”.
- Pjesëmarrës si anëtar i komisionit për ankesa për punë inspektuese, ku morëm vendim për refuzimin e ankesë kundës vendimit të inspektoriatit të komunës.
- Takim pune në zyre me drejtoreshën për mbjrojtje dhe shpëtim, drejtoreshën e Harejas, qëllimi i takimit ishte diskutime rreth organizimit të ndonjë aktiviteti për 8 Mars.
- Takim me kryetarin e komunës, ku e informova për disa aktivitete që kemi planifikuar ti mbajmë për 8 Mars.
- Komente për - Draft Raporti i përmbushjes së Obligimeve nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar – Dhjetor 2023.
- Takim me kryetarin dhe grupin e performancës komunale, për fillimin e raportimit të performancës për periudhën Janar – Dhjetor 2023.
- Mbledhja e jashtëzakonshme e KKS-së, tema – Shqyrtimi i gjendjes aktuale të sigurisë në Komunën e Rahovecit.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

- Qendra e Trajnimit të AKK-së organizojë një Trajnim/Punëtori për Kolegjiumin e Zyrtarëve për Barazi Gjinore me temën: “Barazia Gjinore Online, trendet dhe strategjitë inovative për ndryshim”. Qëllimi i tij është që të pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe aftësi për përdorimin e rrjeteve sociale në ndërgjegjësimin dhe promovimin e barazisë gjinore në komunitetin e tyre.
- Takim me kryetarin dhe grupin e performancës komunale, u takuam për t’u koordinuar rreth angazhimit dhe përgaditjes për raportimin e të dhënave në sistem për vitin 2023.
- Takim me grupin joformal, tek shoqata e gruas “Hareja”, qëllimi i takimit ishte rreth organizimeve për ditën e gruas 8 Marsi.
- Në kuadër të aktiviteteve të 8 Marsit shoqata “Hareja” organizoi ligjeratë për “Parandalimin e dhunës, vetëdijësim dhe raportim, ku ligjërues ishin Policia e Kosovës SP në Rahovec.
- **Aktivite për 8 Mars – Dita ndërkombëtare e Gruas**  
Ditën e filluam së bashku me kryetarin e komunës dhe drejtoreshat e drejtorive, ku u takuam me gratë dhe vajzat që punojnë në administratën komunale, për t’u uruar 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas, duke u dhuruar nga një lule. Në këtë ditë të shënuar, kujtojmë rolin e pazëvendësueshëm të gruas në të gjitha periudhat historike, si dhe në ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë sonë.  
Së bashku me drejtoreshën për Mbrojtje dhe Shpëtim, Shoqatën “Hareja” dhe “SHL Kosova”, vizituam drejtoreshat e shkollave dhe Policet e Stacionit Policor në Rahovec, duke ju uruar 8 Marsin dhe i’u dhuruam nga një lule për punën dhe përkushtimin e tyre. Po ashtu, me moton “Marshojmë s’festojmë”, në bashkëpunim me OJQ-të “Hareja”, “Shl Kosova” dhe me grupin joformal të grave marshuam për ti thënë JO Dhunës.
- Takim në zyrë me zyrtarin nga USAID Selajdin Cena, qëllimi i takimit ishte diskutim për themelimin e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, si dhe rishikimi i anëtarëve të këtij mekanizmi.
- Mbledhja e dytë e rregullt e KKS-së.
- Pjesëmarrës në konferencën hyrëse e Javës së Gruas 2024 e organizuar më 19-20 mars, 2024, tema kryesore e Javës së Gruas 2024 ishte “Udhëhiq me Gjithëpërfshirje: Ndërturja e Politikës me Ekonominë”.
- Takim me kryetarin e komunës, grupin e performancës dhe drejtorët e drejtorive, u takuam për të analizuar në mënyrë të detajuar raportimin përfundimtar të të dhënave në sistem për vitin 2023.
- Me vendim të kryetarit punë shtesë - Zyrtar kontaktues për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhënave në Komunën e Rahovecit.  
Njoftimi dhe regjistrimi në sistemin elektronik i personave zyrtarë që kanë për të deklaruar pasurinë si deklarim i rregullt gjatë muajit Mars 2023.
- Takim me kryetarin, drejtorët e drejtorive dhe anëtarët e grupit të performancës komunale, rishikimi i indikatorëve për raportim në performancë.
- Takim në zyrën e kryetarit, me përfaqësuesit nga OSBE Daniel Lezo dhe Selajdin Cenën, me të cilët u bisedua për mundësin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje dhe mënyrën e

#### KOMUNA RAHOVEC

funksionimit të tij në Komunën e Rahovecit, që ka për qëllim koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në trajtimin e këtyre çështjeve. U dakorduam që sipas kryetarit punëtorja për themelimin e mekanizmit koordinues të mbahet me 24 maj.

- Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës mbajti punëtorinë një ditore të Kolegjiumit për Barazi Gjinore, qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte diskutimi i çështjeve me interes lidhur me: Projektligjin për Banim Social dhe Përbalueshëm, në mënyrë që të mund të japim komente deri sa ky ligj është në diskutim publik.
- Ligjeratë në shkollën e Mesme të Ulët "Sadedin Hajda" në Rahovec dhe shkollën e Mesme të Ulët "Bajram Curri" në Krushë e Madhe, organizuar nga Zyra e Avokatit të Popullit në Gjakovë, av. Mark Kaqinari dhe Koordinatorën për të drejtat e njeriut, ku u mbajtën ligjeratë për fëmijët me temat rreth njohurive të tyre për të drejtat e fëmijëve, po ashtu u mbajë ligjeratë edhe për mësimdhënësit e këtyre dy shkollave.
- Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) organizojë punëtorinë e radhës (vazhdimësi e aktivitetit të mbajtur gjatë vitit 2023) mbi "Identifikimi i Mekanizmave të Brendshëm Institucional për mbrojtje të dinjitetit, barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit brenda Komunave".
- Aktivitet, Në kuadër të projektit "Femme Forward", Rrjeti Qeliza" e cila ka kontratë bashkëpunimi me Kryetarin e komunës dhe zyren për Barazi Gjinore, organizoi diskutim në tryezë të rrumbullakët me temë "Promovimi i pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse", ku u diskutua pjesëmarrja e grave në dëgjime buxhetore, proceset vendimmarrëse dhe promovimi i barazisë gjinore dhe buzhetit të përgjegjshëm gjinor.
- Takim informues nga Agjencia për Barazi Gjinore, ku u diskutua mbledhja e të dhënave për hartimin e raportit të vlerësimit final të Planit të Veprimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe njoftimi rreth thirrjes publike për mbështetje financiare për gra apo vajza që gëzojnë pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë.
- Takim online në kuadër të projektit "Diaspora për gratë në Politikë" nga organizata GERMIN. Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i grave në politikë në nivel lokal në Kosovë. Në projekt janë të përfshira komunat: Shtime, Istog, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Rahovec dhe Podujevë, nga të gjitha subjektet politike.
- Mbledhja e tretë e rregullt e KKS-së.
- Pjesëmarrës në dëgjimin publik buxhetor me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë.
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike në bashkëpunim me Fondacionin Terre des hommes Lausanne, në Kosovë, organizoi trajnimin me temën "Hyrje në Antigjipsizëm", Ky trajnim ka për qëllim njoftimin me termin antigjipsizëm dhe ngritjen e vetëdijes, në mesin e zyrtarëve publik mbi antigjipsizmin si formë specifike e racizmit e cila shpesh shprehet me dhunë, gjuhë të urrejtjes, stigmatizim social, si dhe forma të tjera të diskriminimit.
- Themelimi i Mekanizmit Komunal Koordinues kundër Dhunës në Familje në komunën e Rahovecit, ku me shumicë votash u zgjedha Koordinator i mekanizmit komunal koordinues kundër dhunës në familje. Përkrahur nga OSBE.

#### KOMUNA RAHOVEC

- Punëtori e organizuar nga USAID me temën: Të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave në Kosovë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte përmirësimi i kuptimit dhe zbatimit të të drejtave pronësore dhe trashëgimore për gratë në Kosovë.
- Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren për nder të 25 vjetorit përkujtojnë punën e përkushtuar për avancimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.
- Puntori e organizuar nga DEMOS me temën: Korniza Ligjore në fuqi që rregullon përshtirjen e grupeve të marginalizuara në shoqërinë Kosovare.
- Përgaditja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor për KAB-in 2025-2027.
- Formimi i Asamblesë Komunale të fëmijëve, mbledhja e parë.
- Pjesëmarrës në trajnim të organizuar nga MPB - Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, me temën: Udhëzuesi për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të politikave të integritit të të huajve dhe qasjes së tyre në skemat e integritit.
- Takim me kryetarin e komunës, drejtoreshën e përgjithshme të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, dhe me Udhëheqësin e Divizionit për Raportim dhe Monitorim, me qëllim të promovimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike në Komunën e Rahovecit.
- Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës, mbajti takim me kryesinë e Kolegjiut të Zyrtarëve për Barazi Gjinore, me temën Rishikimi i punës së Kolegjiut, Sfidat dhe Mundësitë, Rekomandime.
- Pjesëmarrës në eventin përmbyllës të projektit “ Mundësi për të gjithë” në shoqatën “Hareja”.
- Mbledhja e katërt e rregullt e KKS-së.
- Punë shtesë - Përgaditja e Raportimit të Përbushjes së Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane Janar – Qershor 2024.
- Programi i USAID Kontrata Sociale, pjesëmarrës në “Punëtorinë Konsultative dy ditore me zyrtarët komunal të Komunës së Rahovecit” për të identifikuar objektivat për pjesëmarrje publike dhe avancuar qasjen e institucioneve publike, në raport me pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal.
- Mbledhja e parë e Mekanizmit Komunal Koordinues kundër Dhunës në Familje në komunën e Rahovecit.
- Takim pune me kryetarin, drejtorët e drejtorive dhe me grupin e performancës komunale, qëllimi i takimit ishte Raporti Përfundimtar i performancës nga MAPL.
- OSBE: Punëtori për finalizimin e planit të veprimit të Mekanizmit koordinues komunal kundër dhunës në familje në Rahovec, ku edhe unanimisht u votua Plani.
- Mbledhja e pestë e KKS-së.
- Plotësim i pyetësorit Aktiviteti Kontrata Sociale i USAID-it, në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e komunës.
- Marrja pjesë në tryezën e rrumbullakët me temën “Dhuna dhe Urrejtja”, në këtë takim do të diskutohet se sa është prezentë dhuna dhe urrejtja në komunën tonë dhe për statistikat e dhunës, organizuar nga Shoqata “Gruaja Fermere” në sallën e SHL KOSOVA.

## KOMUNA RAHOVEC

- U mbajt konsultimi publik për përgatitjen e Projekt planit lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore 2024-2026. Si koordinator i mekanizmit komunal kundër dhunës në familje, paraqita në pika të shkurtëra Projekt planin dhe veprimet që duhet të ndërmarrin institucionet relevante për parandalimin e dhunës në familje. Ky Draft-Plan i veprimit për mbrojtje nga DHF, DHBGJ, DHNG është në konsultim publik deri më 15 shtator 2024.
- Këshilli Komunal Veprues (KKV-ë) i komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë organizoi: “Punëtori në fushën e anti-diskriminimit, gjithëpërfshirjes, dhe zhvillimit të aftësive të buta për arsimim dhe punësim”.
- Takim në zyre me zyrtarët nga USAID dhe drejtorin e ekonomisë, drejtorin për Kadastër, tema e diskutimit ishte të arriturat përmes Planit të Veprimit në bashkëpunim me USAID për komunën e Rahovecit.
- Pjesëmarrës në konferencën përmblylëse nën temën kryesore “Udhëhiq me Gjithëpërfshirje: Ndërthurja e Politikës me Ekonominë”. Pjesë programore e konferencës përmblylëse ishte certifikimi i pjesëmarrësve të Javës së Gruas 2024 që kanë përfunduar me sukses programin nga muaji mars - shtator 2024.
- Trajnim treditör organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me UN Women me temën: “Promovimi i Barazisë Gjinore përmes teknologjisë Informative të Avancuar”.
- Pjesëmarrës në takim tek shoqata e gruas “Hareja” me temën Diskutim mbi të drejtat dhe rolin e gruas në shoqëri, organizuar nga Voice of Roma, Ashkali and Egyptians in Kosovo.
- Tryezë e organizuar nga Avokati i Popullit për të diskutuar lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.
- Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në kuadër të aktiviteteve të saj, mbajti trajnimin: “Ndërtimi i Lidhjeve për Zhvillim të Qëndrueshëm – Gratë Shtyllë e bashkëpunimit Lokal” me Anëtarët e Grupeve jo-formale të Grave nga komunat e rajonit të Prizrenit.
- Mbledhja e dytë e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje.
- Mbledhja e gjashtë e KKS-së.
- Si pikë e rendit të ditës në KPF – Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2026, ku si koordinator i këtij Mekanizmi bëra prezantimin e këtij Plani, i cili Plan u votua dhe do të paraqitet si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës të Kuvendit Komunal.
- Rrjeti Qliza, në kuadër të projektit “Femme Forward”, organizoi tryezë të rrumbullakët me temën “Normat sociale dhe qëndrimet shoqërore”.
- Takim pune me zyrtaren nga DEMOS-i dhe grupin e performancës komunale me qëllim të përkrahjes së komunave për të përmiresuar raportimin në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK).

## KOMUNA RAHOVEC

- Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal, ku e bëra prezantimin Draft-Plani Lokal Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza Gjinore, ku plani u votua nga anëtarët e kuvendit.
- Takim në sallën e Kuvendit Komunal me ftesë të Këshilltares së Kryeministrit për Cështjet e Komuniteteve Elizabeth Gowing, tema Parandalimi dhe Raportimi i Martesave të Hershme në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian me ndihmën e OSBE-së.
- Takim pune me drejtoreshën e shoqatës së gruas "Hareja", Policinë stacioni policor në Rahovec, Përfaqësuesen e SHL Kosova, ku u dakordua që në kuadër të 16 ditë aktivizëm të mbajmë një ligjeratë me gratë dhe të rinjët me temën "Dhuna në Familje dhe dhuna në Baza Gjinore" tek shoqata "Hareja" me datë 29 nëntor.
- Tryezë e rrumbullakët me ftesë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në bashkëpunim me OSCE, me akterët komunal dhe OJQ-të. Qëllimi i takimit ishte për tu njoftuar me hapjen e zyrës për Nduhme Juridike Falas në Rahovec, ku zyra do të jetë e hapur dy herë në javë e Ejte e Premte 8-16. 22.11.2024
- Pjesëmarrës në tryezën regjionale të diskutimit organizuar nga Qenda për Punë Sociale, përkrahur nga OSBE, me temën "Riintegrimi i viktimave të dhunës në familje".
- Pjesëmarrës në Konferencën Përmbyllëse të projektit Fuqizimi Ekonomik i Grave në Zonat Rurale në Kosovë, organizuar nga CARE Deutschland e.V. WEERA, Zyra në Kosovë.
- Aktivitet – Në kuadër të fushatës 16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore, Zyra për Barazi Gjinore, bashkë me shoqatën "Hareja" dhe "SHL Kosova", organizuam takim me gratë dhe të rinjët e komunës tonë, me temë "Dhuna në baza gjinore dhe parandalimi i saj" në takim ishte edhe Policia e Kosovës SP/Rahovec; QPS dhe QKMF.
- Pjesëmarrës në punëtorin mbi format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm organizuar nga ATRC në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- Mbledhja e shtatë e KKSBE-së.
- Organizata Joqeveritare Advancing Together në bashkëpunim me Zyren për Qeverisje të mirë-Zyra e Kryeministrit, mbajti trajnim mbi Kornizën e Indikatorëve për monitorimin e zbatimit të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.
- Takim në zyre me LMT KFORI austriak, ku u diskutua për punët e bëra gjatë vitit 2024 nga zyrtari për Barazi Gjinore si: raportim të statistikave të dhunës në familje, Mekanizmi komunal kundër dhunës në familje, numri i punëtorëve në administratën komunale, në drejtorin e Arsimit dhe QKMF-të.
- Pjesëmarrës në eventin përmbyllës të shoqatës "Hareja" ku u prezantuan aktivitetet e shoqatës nga stafi i tyre si dhe shpërndarja e mirënjohjeve për bashkëpunuesit.

**Alban Gashi**

*Alban Gashi*

**Zyrtar për Barazi Gjinore**

**Komuna Rahovec**

06.01.2025

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Administratë të përgjithshme